

**DEKLARATË E KRYETARËVE TË BASHKIVE DHE PËRFAQËSUESVE TË ZGJEDHUR
 VENDORË DHE RAJONALË
 TË SHTETEVE ANËTARE TË KËSHILLIT TË EVROPËS
 KUNDËR ANTI-CIGANIZMIT**

UNË, SI KRYETAR BASHKIE/ PËRFAQËSUES I ZGJEDHUR VENDOR DHE RAJONAL,

Duke marrë parasysh thirrjen e bërë nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale dhe nga Përfaqësuesi Special i Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës mbi Çështjen e Romëve për të gjithë përfaqësuesit e zgjedhur vendorë për të mbajtur një qëndrim të qartë kundër anti-Ciganizmit,

Duke pasur parasysh instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të nënshkuara dhe/ose të ratifikuara nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, veçanërisht nga Konventa Evropiane për të drejtat e Njeriut (ECHR) dhe Protokollat e saj. Karta Sociale Evropiane (e rishikuar), Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Deklarata dhe Plani i Veprimit për luftën kundër racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës ("Deklarata e Vjenës"), miratuar në Konferencën Botërore për të Drejtat e Njeriut në vitin 1993, Deklarata e Strasburgut mbi Romët (2010) dhe Plani Tematik i Veprimit për Përfshirjen e Romëve dhe Endacakëve¹ nga Këshilli i Evropës;

Duke pasur parasysh Nenin 1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD), i cili përcakton diskriminimin racor si "[...] çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes etnike apo kombëtare i cili ka për qëllim të ndikojë në prishjen ose dëmtimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit në mënyrë të barabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në çdo fushë tjetër të jetës publike [...]";

¹ Termi "Romët dhe Endacakët" është përdorur në Këshillin e Evropës për të përfshirë shumëllojshmërinë e gjerë të grupeve të mbuluara nga puna e Këshillit të Evropës në këtë fushë: nga njëra anë a) Romë, Sinti/Manush, Kale, Kaale, Romani, Boyash/Rudari; b) Egjiptianët Ballkanikë (Egjiptianët dhe Ashkalinjët); c) Grupet Lindore (Dom, Lom dhe Abdal); dhe, nga ana tjetër, grupet e tilla si Endacakët, Yenish, si dhe popullatat e përcaktuara nën termin administrativ "Gens du voyage", si dhe personat të cilët e identifikojnë veten si Ciganë.

Duke marrë në konsideratë Rekomandimin e Politikës së Përgjithshme (2011) nr. 13 të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) në luftën e anti-Ciganizmit dhe diskriminimit të romëve;

Duke pasur parasysh Rezolutën 333 (2011) të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës për përfshirjen e Romëve si një sfidë për autoritetet lokale dhe rajonale, Rezolutën 366 (2014) për fuqizimin e të rinjve Romë nëpërmjet pjesëmarrjes, Rezolutën 403 (2016) mbi situatën e Romëve dhe Endacakëve në kontekstin e rritjes së ekstremizmit, ksenofobisë dhe krizës së refugjatëve në Evropë dhe Deklaratën Përfundimtare të Samitit të Kryetarëve (2011);

Duke pranuar që anti-Ciganizmi është një formë specifike racizmi;

Duke kujtuar që sipas këtyre instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, liritë politike nuk duhet të lejohet të keqpërdoren për të shfrytëzim, shkaktim, ose për inicim paragjykimesh në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes etnike apo kombëtare ose për të kërkuar për të fituar simpatinë e elektoratit mbi baza të tilla për paragjykitime;

Duke qenë të vetëdijshëm për detyrat e veçanta dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale dhe rajonale si aktorë në procesin politik demokratik, duke siguruar një platformë për të dhe duke integruar pikëpamje të ndryshme në procesin e vendimmarrjes politike, duke i mundësuar shoqërisë zgjidhjen e konflikteve të interesit dhe të mendimeve midis grupeve të ndryshme shoqërore përmes dialogut dhe jo përmes anashkalimit dhe konfliktit; dhe duke zgjedhur përfaqësues të niveleve të ndryshme për një pjesëmarrje aktive në procesin politik;

Të bindur që përfaqësimi i grupeve etnike minoritare, veçanërisht Romëve dhe Endacakëve, në procesin politik është një pjesë integrale e procesit demokratik, pasi partitë politike janë, ose duhet të përpiqen të jenë, një reflektim i shoqërisë;

ANGAZHOHEM NË:

- **mbrojtjen** e të drejtave të njeriut dhe të parimeve demokratike dhe për të hedhur poshtë të gjitha format e diskriminimit, dhunës, ngacmimit, nxitjes së urrejtjes dhe

gjuhës së urrejtjes ndaj Romëve dhe Endacakëve dhe të çdo forme tjetër të anti-Ciganizmit;

- **refuzimin** për të shfaqur, publikuar ose për të pasur të publikuar, për të shpërndarë ose miratuar në çfarëdolloj mënyre pikëpamjet dhe pozicionet që ndezin ose nxisin, apo në mënyrë të arsyeshme mund të pritet që të stimulojnë ose nxisin armiqësi apo përçarje mes njerëzve me prejardhje të ndryshme etnike apo kombëtare, dhe për t'u përfshirë me dhunë në ndonjë ndjenjë dhe sjellje anti-Romësh dhe anti-Endacakësh brenda vetë radhëve tona;
- **tërheqjen nga** çdo formë aleance politike apo bashkëpunimi të çdo niveli me ndonjë parti politike ose autoritet lokal dhe rajonal të cilat nxisin apo përpiqen të ndezin paragjykimet racore apo etnike dhe urrejtjen racore;
- **përpjekjen për** përfaqësimin e drejtë të Romëve dhe Endacakëve në të gjitha nivelet e demokracisë me një përgjegjësi të veçantë për kreun e autoritetit lokal dhe rajonal për të nxitur dhe të mbështetur rekrutimin e kandidatëve nga këto grupe për funksione politike në nivel lokal dhe rajonal;
- **premtimin e mëtejshëm** për të marrë masat e duhura për të siguruar që të gjithë personat që punojnë për autoritetet lokale dhe rajonale të jenë të vetëdijsëm dhe të veprojnë gjatë gjithë kohës, në përputhje me parimet e mësipërme.

o o o o o

Bashkia/Qarku:

Shteti:

Kryetari i Bashkisë / Përfaqësuesi i zgjedhur vendor apo rajonal:

Data:

Nënshkrimi:
